


**KONTRATE SHITBLERJE PASURIJE TE LUAJTESHME  
PJESE KUOTASH TE SHOQERISE "GOMA" SH.P.K. SHKODER**



Në Dhomen e Noterise Shkodër, dhe para meje noterit të këtij rrethi, Arben Salim Kopliku, me seli ne rrugen "Dos Bosko", karshi Gjykates se Faktit, Shkoder, sot me daten 25. 12. 2000 (njezet e pese dhjetor dymije), u paraqiten personalisht palët e poshtëshenuara kontraktuesat:.....

**Shitës :** **Abdullah Muharrem Rrashketa**, lind e banues në Shkodër, rruga "Emin Jahja", nr. 14, Shkodër.....

**Blerës:** **Zyhdi Muharrem Rrashketa**, lind e banues në Shkoder, si siper.....

Të njohur prej meje si te tille, e me zotesi te plota juridike per te vepruar, me kërkesë të tyre, i redaktova këtë kontratë shitblerje pasurije të luajtëshme, pjese kuotash kapitali themeltar, si më poshtë vijon:.....

Ne baze te vendimit te Gjykatese se rrethit Tirane nr. 21398 date 27 maj 1999, z. Abdullah Rrashketa ka rregjistruar Shoqerine " Goma", sh.p.k., Shkoder, shoqeri e cila eshte rregjistruar prane organit kompetent si person juridik, me objektin e ditur.....

Sipas mareveshjes se bere , z. Abdullah Rrashketa, i shet z. Zyhdi Rrashketa 50 % (pesedhete per qind) te kapitalit themeltar, duke u bere keshtu qe te dy bashkepronar, secili me nga 50 %.....

Ky akt u lidh me titull akt shitblerje pasurije te luajteshme, pjese kuotash te kapitalit themeltar, duke kryer dhe në të njëjten kohë, të gjithë veprimet pranë organeve kompetente...

Aktit i bashkelidhen dhe vendimet e sipertreguara te Gjykates se rrethit Tirane.....

Kjo kontratë, pasi u lexue me zë të lartë para palëve kontraktuesat, të cilët, duke u gjetur konform kërimit dhe vullnetit të tyre të plotë, në prezencen time, e pranuan atë, dhe e nënshkruan si me poshte rezulton:.....

Palët kontraktuesat

Shitës  
Abdullah Rrashketa

Blerës  
Zyhdi Rrashketa

